



|                           |                    |   |
|---------------------------|--------------------|---|
| REPubLIKA E KOSOVËS       | REPubLIKA KOSOVA   | 1 |
| GJYKATA SUPREME E KOSOVËS | VRHOVNI SUD KOSOVA |   |
| G.J.A-Su.A                | 190/2020           |   |
| Dt:                       | 25/09/2020         |   |
| PRISHTINË - PRIŠTINA      |                    |   |

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 24 shtator 2020 me vota unanime, nxjerr këtë:

## UDHËZIM

Për zbatimin e detyrueshëm të aktvendimeve të gjykatave themelore - divizionet për kundërvajtje, në Republikën e Kosovës, që kanë të bëjnë me shqiptimin e gjobave në të holla, janë kompetent përmbaruesit privat në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 30.4 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe nenin 3 dhe 5.6 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore të Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

Projekti JSSP nga USAID, dhe gjykatat themelore – divizionet e kundërvajtjeve, në Kosovë, kanë paraqitur shqetësimin për mos zbatimin e aktvendimeve të këtyre gjykatave lidhur me gjobat e shqiptuara me këto aktvendime, për shkak të paqartësisë së dy dispozitave të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje në Republikën e Kosovës, nenit 30 dhe 163, lidhur me atë se si dhe kush duhet të bëjë zbatimin e këtyre aktvendimeve.

Është evidente se një pjesë e madhe e aktvendimeve të divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore në Kosovë që kanë të bëjnë me gjobat në të holla, nuk është duke u zbatuar në mënyrë të detyrueshme, për shkak të paqartësive dhe dilemave në zbatimin e dy dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje, neni 30 dhe 163, të cilat dispozita ligjore janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Neni 30.4 i Ligjit për Kundërvajtje parasheh: Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në të holla në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim, dhe urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Kjo do të thotë se kjo dispozitë ligjore, për arkëtimin e gjobës së shqiptuar me aktvendim kundërvajtës na orienton në procedurën përmbarimore. Në kundërshtim të plotë me këtë dispozitë ligjore, orientim tjetër për këtë çështje jep dispozita ligjore e Ligjit për Kundërvajtje, neni 163, në paragrafin 1, ku thuhet se: gjobën e dhënë për kundërvajtjen dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes i ekzekuton gjykata që e ka dhënë ndëshkimin. E po ashtu edhe paragrafi 4 i këtij neni ku thuhet: arkëtimi me dhunë i gjobës për kundërvajtjen e kryer dhe i shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes bëhet sipas dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit. Të dy këta paragrafë të këtij neni janë në kundërshtim me nenin 30.4 të njëjtit ligj, dhe për më tepër, këta dy paragrafë të nenit 163 të këtij Ligji, as nuk kanë logjikë juridike ligjore pasi që për arkëtimin e gjobave të shqiptuara me aktvendime kundërvajtëse nuk është e nevojshme aspak zbatimi i dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit, kur neni 30 par.4 i këtij Ligji na jep drejtimin e qartë dhe të duhur për zbatimin e detyrueshëm të aktvendimeve të departamenteve të kundërvajtjeve të gjykatave themelore lidhur me shqiptimin e gjobave.

Kështu që, duke u bazuar në nenin 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje që orienton qartë dhe pa asnjë dilemë në zbatimin e procedurës përmbarimore me rastin e përmbarimit të detyrueshëm të aktvendimeve të departamenteve të kundërvajtjeve të gjykatave themelore, lidhur me shqiptimin e gjobave, dhe në nenin 3.1 të Ligjit për Procedurë Përmbarimore ku thuhet se: Procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheq dhe për të vendos përmbaruesi privat, ndërsa përjashtimisht, gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton Gjykata ( organ i shkallës së parë ). Lidhur me këtë, menjëherë duhet shtuar se në kuptim të nenit 5.6 të Ligjit për procedurën përmbarimore, Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatojë përmbarimin e vendimeve gjyqësore vetëm lidhur

me të gjitha çështjet nga e drejta familjare, dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civilë në punë dhe kompensimet tjera. Kjo do të thotë se zbatimin e vetëm të këtyre vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë ekskluzivisht me këto çështje, Ligji për Procedurën Përmbartimore e ka lënë në kompetencën e gjykatës, kurse përmbartimin e të gjitha dokumenteve tjera përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, ky Ligj e ka lënë në kompetencën e përmbartuesit privat, çka në pajtim me këtë, rezulton se edhe për zbatimin e detyrueshëm të aktvendimeve të gjykatave themelore-departamenteve për kundërvajtje, në Republikën e Kosovës, që kanë të bëjnë me shqiptimin e gjobave në të holla, janë kompetent përmbartuesit privat në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje, dhe nenin 3 dhe 5.6 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore të Republikës së Kosovës.

*(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 24 shtatorë 2020)*

